

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Kolegji i përbërë nga gjyqtaret Shqipe Qerimi Kryetare, Rasim Rasimi dhe Gani Zabeli, anëtarë me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Jeton Leci, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.T. nga Mitrovica për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.170/2016 të datës 17.08.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 29.09.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.170/2016 të datës 17.08.2017, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktgjykimin P.nr.170/2016 të datës 17.08.2017, të akuzuarin S.T. e ka shpallur fajtor për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe i ka shqiptuar dënim me burim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryen vepër të re penale.

Palën e dëmtuar e ka udhëzuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt civil.

Të akuzuarin gjykata e ka obliguar që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 90€, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 10€, të gjitha këto në afatin prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar :

Prokuroria Themelore në Mitrovicë për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më i lartë.

Prokurori i Apelit me parashtrësën PPA/II.nr.1034/2017, të datës 15.09.2017, ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë të aprovohet si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi dhe ndaj të akuzuarit dhe ti shqiptohet një dënim më i lartë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet në ankesë në ankesë gjeti se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë nuk është e bazuar.

Aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi dhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP dhe gjeti se aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij dhe as shkelje të Ligjit penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase siç rezulton nga shkresat e lëndës i akuzuari e ka pranuar fajësinë, prandaj, sipas nenit 383 par 2 të KPP, ndaj aktgjykimin që është marr në bazë të pranimit të fajësisë, ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve.

Përkitazi me çështjen e dënimit në ankesën e prokurorit pretendohet se gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit, ka nxjerr konkluzion të gabuar për arsyet se dënimi i shqiptuar është i butë dhe jo adekuat në krahasim me veprën e kryer penale e posaçërisht pasojat konkrete dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pretendimi i prokurorit për një dënim më të lartë është i pabazuar. Kolegji i Gjykatës së Apelit gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit siç parashihet në dispozitën e nenit 73 të KPK-së, kështu si rrethana lehtësuese për të akuzuarin mori për bazë pranimin e fajësisë, se është person familjar, mbajtës i familjes, baba i katër fëmijëve, ndërsa si rrethana rënduese gjeti faktin se kryerja e veprave të kësaj natyre janë në rritje e sipër.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit pretendimet e prokurorit për një dënim më të lartë ndaj të akuzuarit janë të pabazuara. Meqenëse në ankesën e prokurorit nuk pati ndonjë rrethanë konkrete rënduese që kishte me ndikuar në ashpërsimin e dënimit e cila nuk ka qenë objekt i vlerësimit nga gjykata e shkallës së parë si dhe duke patuar parasysh se gjykata e shkallës së parë të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin e paraparë ligjor, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se dënimi i shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në përpjesëtim me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe në shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i parashikuar me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së, ku do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga kjo që u tha më lartë e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr. 1017/17, me dt. 29.09.2017

Procesmbajtës
Jeton Leci

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

1. Rasim Rasimi

Shqipe Qerimi

2. Gani Zabeli